



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”

SHPALLJE KËRKESE PËR DONACION

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullit, të cilit i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas ligjeve në fuqi, i cili ka në fokus të aktivitetit të tij mbrojtjen e jetës, shëndetit fizik dhe mendor të pacientit dhe lehtësimin e vuajtjeve të tij, duke i ofruar një shërbim shëndetësor sa më cilësor dhe dinjitoz.

Me anë të kësaj thirrje, QSUNT dëshiron të kërkojë vëmendjen e publikut lidhur me mundësinë për të kontribuar në përmirësimin e shërbimit dhe ofrimin e ndihmës në rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve të hospitalizuar në QSUNT.

Nisur nga nevoja për vijueshmërinë e ndërhyrjeve së Kataraktës, lutemi për donacion me bazë materiale për kirurgjinë e kataraktës, lente intraokulare, viscoelastic dhe bojë blumetilen me sasinë 100 lente intraokulare, 50 viscoelastike dhe 10 bojë blumetilen, për një mbarëvajtje dhe për ofrimin sa më të mirë të shërbimit ndaj pacientit në Shërbimin e Okulistikës.

QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”